


RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS PËR SESSIONIN PRANVEROR 2019

Prishtinë, tetor 2019



**RAPORT PËR
MONITORIMIN
E PUNËS SË KUVENDIT
TË KOSOVËS PËR
SESSIONIN
PRANVEROR 2019**

Prishtinë, tetor 2019

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

Shënim: Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Kuvendit gjatë sesionit pranveror 2019 dhe është realizuar në kuadër të projektit "Rritja e Pjesëmarrjes, Transparencës dhe Llogaridhënies në Kosovë", financuar nga Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara (UNDEF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk reflekton qëndrimet e donatorit.

UNDEF
The United Nations
Democracy Fund



FNUD
Fonds des Nations Unies
pour la démocratie

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1. HYRJE.....	6
2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE	7
3. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE	11
3.1 Komisionet hetimore	16
3.2 Komisionet ad – hoc.....	16
4. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE	17
4.1 Seancat plenare	18
4.2 Seancat e jashtëzakonshme	18
4.3 Seancat solemne.....	19
4.4 Pjesëmarrja e deputetëve në seanca	19
5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE.....	21
5.1 Pyetjet Parlamentare.....	21
5.2 Interpelancat.....	26
5.3 Debatet parlamentare.....	26
5.4 Rezolutat	28
5.5 Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura.....	30
5.6 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.....	30
5.7 Raportimi i ministrave në komisionet parlamentare.....	32
6. SHPENZIMET E KUVENDIT	33
7. UDHËTIMET E DEPUTETËVE JASHTË VENDIT	34
8. REKOMANDIMET	38
SHTOJCAT	39
SHTOJCA 1 - Pjesëmarrja e deputetëve në Komisione Parlamentare.....	39
SHTOJCA 2 – Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare	46



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të ushtrojë plotësisht funksionet e tij as gjatë sesionit pranveror të punës të këtij viti. Organizimi jo i mirë i punës së Kuvendit dhe mungesa e theksuar e kuoromit në procesin e votimeve - problematika të trashëguara nga viti 2018, kanë kontribuar në bllokimin e punës së Kuvendit, deri në shpërndarjen e tij. Për rrjedhojë, puna e Kuvendit gjatë këtij sesioni është fokusuar në tentativat për t'iu dhënë epilog pikave që janë vënë për votim që nga viti i kaluar. Këto përpjekje jo vetëm që nuk ka dhënë rezultat pozitiv por kanë ndikuar edhe në dinamikën e seancave të reja plenare. Vetëm gjashtë seanca të reja plenare janë inicuar gjatë gjithë sesionit pranveror të këtij viti, ndërsa seancat e jashtëzakonshme kanë zënë vend kryesor. Me gjithsej 15 seanca të jashtëzakonshme, sesioni pranveror parlamentar i 2019-tës ka shënuar rekord sa i përket seancave të jashtëzakonshme të mbajtura në një sesion të punës së Kuvendit nga të gjitha legjislaturat. Krahas mos organizimit të punës së Kuvendit, punimet plenare janë përcjellë me mungesa të shumta të deputetëve. Njëqind e njëzet deputetët e Legjislaturës së VI-të në për këtë sesion kanë shënuar gjithsej 685 mungesa.

Kuvendi ka dështuar të miratojë Rregulloren e re të punës për shkak të mungesës së konsensusit të grupeve parlamentare për përmbajtjen e saj. Kjo draft-rregullore ishte në procedurë të shqyrtimit që nga fillimi i vitit 2018. Përkundër punës njëvjeçare që është bërë në këtë drejtim, si pasojë e mungesës së vullnetit politik, kjo draft-rregullore nuk ishte përkrahur as nga vet Komisioni që e kishte draftuar. Për rrjedhojë, shpërndarja e legjislaturës së VI-të e kthen këtë proces në pikën fillestare.

Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar punimet gjatë këtij sesioni pa një plan të punës anipse me Rregulloren të Punës obligohet që

ta miratojë një të tillë. Duke u thirrur në programin legjislativ të Qeverisë për Kuvendin, projektligjet e bartuara nga viti paraprak dhe nismat ligjore që i ka ndërmarrë Kuvendi, numri i përgjithshëm i projektligjeve që Kuvendi do të duhej të shqyrtonte është 143. Në sesionin pranveror, Kuvendi ka arritur që të miratojë 29 ligje apo 20% të numrit të përgjithshëm të projektligjeve që do të duhej të shqyrtoheshin këtë vit. Ndërkohë në komisionet parlamentare, në procedurë për shqyrtim kishin mbetur edhe 43 projektligje (30%), ndërsa 71 projektligje (50%) nuk janë dorëzuar për shqyrtim. Prej 29 ligjeve të miratuara, 26 prej tyre janë nga agjenda e vitit të kaluar ndërsa vetëm tri prej tyre janë ligje të reja të këtij viti.

Megjithatë, kjo legjislaturë ka qenë dukshëm më efikase në inicim të legjislacionit, ku në sesionin pranveror të këtij viti komisionet e Kuvendit dhe deputetët, së bashku, kanë inicuar gjithsej te të nisma ligjore.

Mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit për periudhën raportuese ka qenë e dobët. Krahasuar me sesionin e kaluar pranveror, gjatë së cilit u parashtruan gjithsej 238 pyetje parlamentare, ky sesion është shquar për numër shumë të vogël të pyetjeve parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar, me vetëm 94 sosh nga 30 deputetë. Ky mekanizëm është ushtruar në masë të madhë nga subjektet opozitare, ku 85 pyetje janë parashtruar nga deputetët e opozitës, ndërsa vetëm 9 nga deputetët e shumicës parlamentare. Për periudhën raportuese, Kuvendi ka mbajtur vetëm dy interpelanca dhe 12 debate parlamentare, 11 prej të cilave nuk kanë përfunduar për shkak të mungesës së kuoromit për të votuar rezolutat/rekomandimet e nxjerra nga ato debate. Ndërkaq, komisionet parlamentare kanë ftuar për raportim 38 herë ministrat e kabinetit qeveritar, po aq sa kishin raportuar edhe në sesionin pranveror të vitit të kaluar.





Komisionet parlamentare së bashku kanë shqyrtuar vetëm 21 raporte vjetore të 34 institucioneve të pavarura që mbikëqyren nga Kuvendi dhe 9 raporte të auditimit të institucioneve, mirëpo asnjë nga këto raporte nuk ishin miratuar në seancë. Për mungesë kuorumi kanë dështuar të emërohen 19 anëtarëtë bordeve për disa institucione të pavarura brenda afatit kohor ndërkaq pesë anëtarë të pesë institucioneve të tjera të pavarura nuk kanë arritur të marrin vota të mjaftueshme për çka është përsëritur konkursi.

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve ka qenë e mangët. Nga 21 ligje të parapara për mbikëqyrje gjatë këtij sesioni, vetëm 10 prej tyre ishin monitoruar nga komisionet parlamentare. Pesë komisione kishin arritur të përfundonin raportet e monitorimit, por jo edhe t'i vendosnin në seancë. Si rrjedhojë Kuvendi nuk kishte arritur që të miratojë asnjë raport të monitorimit të zbatimit të ligjeve për vitin 2019.

Gjatë sesionit pranveror, komisionet parlamentare kanë realizuar gjithsej 227 mbledhje dhe 11 dëgjime publike, që krahasuar me statistikën me vitin 2018 (përfashtim komisioneve hetimore dhe atyre ad-hoc), del të jenë mbajtur 25% më pak mbledhje këtë vit. Përveç seancave, mungesa e kuorimit është kthyer në problematikë edhe në mbledhje të komisioneve parlamentare. Përderisa në punimet plenare kishte mungesë të **kuorimit në votime**, në mbledhjet e komisioneve ka pasur mungesë të kuorimit të nevojshëm edhe për **mbajtjen e mbledhjeve**, që vjen si rezultat i mungesës fizike të deputetëve në mbledhje. Në mungesë kuorumi 23 mbledhje të komisioneve kanë dështuar të mbahen. Numri i mungesave të deputetëve në punimet e komisioneve parlamentare ishte 775.

Përveç punës së komisioneve funksionale, ky sesion është karakterizuar më shumë me punën e **komisioneve hetimore** dhe atyre ad-hoc. Megjithatë për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, ka lënë në gjysëm misionet e këtyre komisioneve, shumica prej të cilave ishin në proces të zhvillimit të punimeve. Vetëm dy nga këto komisione arritën të miratojnë raportin final në seancë.

Kuvendi ndonëse me vonesë, në muajin korrik ka publikuar raportin financiar për shpenzimet e realizuara gjatë periudhës janar – mars të këtij viti. Bazuar në të dhënat e raportit, shihet se 43 deputetët kanë shpenzuar rreth 50,659 € në 64 udhëtime të realizuara. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar vërehet një rritje e lehtë e mesatares së shpenzimeve për udhëtim në periudhën raportuese megjithatë as ky raport financiar nuk specifikon arsyet e vizitave dhe të dhënat për shpenzimet e biletave.





1. HYRJE

Ky raport paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror të vitit 2019. Gjatë periudhës raportuese, KDI ka përcjellë në mënyrë aktive mbarëvajtjen e punimeve të Kuvendit dhe përputhshmërinë me Rregulloren aktuale të Punës së Kuvendit. Raporti përmban të dhëna statistikore që janë mbledhur nga monitoruesit e KDI-së, të cilët kanë përcjellë të gjitha mbledhjet e komisioneve parlamentare, Kryesisë së Kuvendit si dhe seancat plenare. Këto të dhëna janë analizuar dhe prezantuar në mënyrë të detajuar, për të pasqyruar punën e Kuvendit.

Në pjesën e parë, raporti analizon përmbushjen e agjendës legjislative dhe procesin e trajtimit të projektligjeve nga ana e Kuvendit. Në pjesën e dytë, raporti trajton mbarëvajtjen e seancave dhe mungesat e deputetëve në punimet e Kuvendit, për të vazhduar më tutje me performancën e komisioneve parlamentare. Tutje, ky raport pasqyron në detaje aktivitetet mbikëqyrëse të Kuvendit ndaj punës së ekzekutivit, si dhe procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve. Raporti po ashtu përfshin shpenzimet e Kuvendit dhe udhëtimet jashtë vendit të deputetëve. Përmes shtojcave, ky raport paraqet në mënyrë të detajuar edhe pjesëmarrjen e deputetëve në punimet e Kuvendit, qoftë në seanca plenare apo në mbledhje të komisioneve parlamentare.



2. PËRMBUSHJA E AGJENDËS LEGJISLATIVE

Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar punimet e sesionit pranveror 2019 pa një plan vjetor të punës përkundër që me Rregulloren të Punës është e përcaktuar që të miratohet një i tillë. Ndonëse planprogrami për këtë vit ishte përgatitur në fund të muajit janar, të njëjtin Kryesia e Kuvendit nuk e kishte vënë në rend dite deri në fund të muajit mars. Mirëpo, pavarësisht faktit që ishte listuar si pikë e rendit të ditës për tu diskutuar, kjo nuk u vendos asnjëherë në diskutim nga kryesuesi i secansës dhe për rrjedhojë as nuk është hedhur në votim.

Sa i përket agjendës legjislative, Kuvendi kishte nisur punimet për këtë vit me 55 projektligje në procedurë të bartura nga viti paraprak, të cilat nuk kishin arritur të përfundonin

pavarësisht planifikimeve. Bazuar në programin legjislativ 2019 të Qeverisë për Kuvendin, projektligjeve të bartura nga viti paraprak dhe planeve të punës së komisioneve për këtë vit, numri i projektligjeve të parapara për shqyrtim ishte 143.

Gjatë punimeve të sesionit pranveror, Kuvendi ka arritur që të miratojë 29 ligje apo 20% të numrit të përgjithshëm të projektligjeve që do të duhej të shqyrtoheshin brenda këtij viti. Ndërkohë në komisionet parlamentare, në procedurë për shqyrtim kishin mbetur edhe 43 projektligje (30%), ndërsa 71 projektligje (50%) nuk janë përgatitur për procedim në Kuvend.





Nga numri i përgjithshëm i ligjeve të miratuara gjatë periudhës raportuese, prej tyre janë 12 ligje të reja, 10 prej tyre janë ligje në plotësim – ndryshim dhe 7 të tjera janë ligje për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ndërkaq nëse i ndajmë ligjet e miratuara sipas sponsorizuesëve del që numri më i madh i tyre gjegjësisht 27 prej tyre, janë të

sponsorizuara nga Qeveria dhe dy të tjera janë nisma ligjore të sponsorizuara nga Kuvendi. Prej 29 ligjeve të miratuara, 26 prej tyre janë nga agjenda e vitit të kaluar të cilat veçse kanë qenë në procedurë të shqyrtimit gjatë vitit paraprak dhe janë bartur për këtë vit, ndërkaq vetëm tri nga ligjet e miratuara i takojnë agjendës së këtij viti.




FIG. 2 Llojet e ligjeve të trajtuara nga Kuvendi gjatë sesionit pranevror 2019

Kjo legjislaturë ka qenë dukshëm më efikase krahasuar me legjislaturat tjera në inicim të legjislacionit, ku vetëm për këtë vit komisionet e Kuvendit dhe deputetët, së bashku, kanë iniciuar gjithsej 8 nisma ligjore të reja. Nga viti i kaluar janë bartur edhe 9 projektligje që ishin nisma të Kuvendit, duke e çuar kështu në 17 numrin e përgjithshëm të nismave ligjore për këtë vit. Prej tyre vetëm 2 kanë arritur që të marrin miratim final në seancë, ndërkaq 15 kanë mbetur në procedurë për shqyrtim nga komisionet përkatëse.

Për dallim nga viti i kaluar, ku sektori i drejtësisë printe me numrin më të madh të ligjeve të miratuara, këtë vit, numri më i madh i ligjeve të miratuara i takon sektorit të financave me dhjetë (10) ligje. Në sektorin e Drejtësisë, Arsimit, Kulturës dhe Administratës janë miratuar nga tre (3) ligje, dy (2) ligje në sektorin e Sportit ndërsa nga një (1) ligj i miratuar i takon sektorit të Punëve të Brendshme, Punëve të Jashtme, Qeverisjes Lokale, Shërbime Publike dhe Drejtave të Njeriut.





FIG. 3 Ligjet e miratuara në sesionin pranveror 2019, të ndara sipas sektorëve

Në vitin 2018, numri i ligjeve të proceduara nga Qeveria në Kuvend ishte më i madh në krahasim me këtë vit. Por që kjo e fundit për shkak të problemeve me mungesën e kuorumit e kishte të pamundur që t'i përfundonte në kohë procesin e miratimit të atyre ligjeve. Zvarritjet në procesin ligjvënës ishin transmetuar edhe në sesionin pranveror të 2019-tës. Tentativat e njëpasnjëshme të Kuvendit që t'i përfundonin pikat që i kishin nisur që nga muaji tetor i vitit 2018, kanë ndikuar drejtpërdrejtë në dinamikën e ulët të punës edhe në Komisionet Parlamentare. Për rrjedhojë, komisionet nuk kanë pasur mundësi të fillojnë fazën e amendamentit të projektligjeve me kohë, meqë të njëjta nuk kanë arritur të marrin aprovim në parim në seancë.

Edhe Qeveria nuk arriti t'a përmbushë planin e saj legjislativ karshi Kuvendit, pasi që numri i ligjeve të proceduara gjatë kësaj periudhe ka qenë shumë i vogël. Vetëm shtatë ligje janë sjellë nga Qeveria për shqyrtim në Kuvend, përkundër që Plani legjislativ i saj përmbante 80 projektligje.

Shkeljet e shpeshta të Rregullores së Punës sidomos në fazën e shqyrtimit të dytë të projektligjeve e kanë shoqëruar edhe këtë sesion të punimeve. Ligji për Pagat dhe Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 ishin dy prej ligjeve që zgjuan më së shumti vëmendje dhe debat në Kuvendin e Kosovës gjatë periudhës raportuese. Kjo erdhi për shkak të situatës që ishte krijuar nga grevat e shumta nga përfaqësues të institucioneve publike që ishin të pakënaqur me kategorizimin e pagave. Procesi i shqyrtimit dhe votimit të tyre final në seancë plenare ishte shoqëruar me shkelje procedurale, ku ligjet në fjalë u amendamentuan në bazë të propozimeve të deputetëve në seancë dhe në shumicën e rasteve propozimet/amendamentet u votuan në grup, veprime këto që janë në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit.¹

Miratimi i ligjeve me procedurë të përshpejtuar ka ndodhur në dy nga ligjet e miratuara gjatë sesionit pranveror, Ligjin për Lojërat e Fatit si dhe ai Për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegcionit Shtetëror të Republikës së

Kosovës në procesin e Dialogut. Ky i fundit, ndonëse ishte miratuar nga Kuvendi, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur antikushtetues. Duke iu shmangur afateve të rregullta kohore të shqyrtimit që parashihen me Rregulloren të Punës, nuk është mundur zhvillimi i debatit të mirëfilltë parlamentar mbi këto ligje dhe njëherit nuk i është dhënë mundësi publikut që të përfshihet në konkluzione gjatë këtij procesi legjislativ.

Ndërkaq, Ligji për Lirinë e Asociimit të Organizatave Joqeveritare ishte kthyer për rishqyrtim në Kuvend me rekomandimet e Presidentit të Kosovës, për shkak të dispozitave jo kushtetuese të përfshira në këtë ligj. Për këtë veprim, fillimisht organizatat e shoqërisë civile kishin ngritë shqetësimin tek grupet parlamentare për amendamentet që ishin propozuar nga Komisioni funksional. Mirëpo kjo kërkesë ishte shpërfillur nga ana e deputetëve, të cilët e kishin miratuar si të tillë në lexim të dytë. Pas procedimit të këtij ligji për dekretim, Presidenti kishte përdorur të drejtën e tij për të mos nënshkruar projektligjin, të cilin e kishte kthyer prapa në Kuvend për rishqyrtim. Shoqëria civile i'u ishin drejtuar sërish deputetëve me kërkesën e tyre për t'i votuar amendamentet e Presidentit që i rikthejnë dispozitat standarde të këtij ligji. Ligji i ishte nënshtruar sërish procesit të votimit me propozimet e Presidentit për çka votuan shumica e deputetëve, duke hedhur poshtë amendamentet fillestare të Komisionit.

Ndërkaq një projektligj tjetër, ai për Financimin e Subjekteve Politike ishte tërhequr nga Kryeministri pas shqyrtimit të dytë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ky veprimi i kryeministrit të atëhershëm Haradinaj kishte ardhë pas presionit të organizatave të shoqërisë civile dhe atyre ndërkombëtare që kundërshtonin amendamentet propozuara nga komisioni përkatës që ishin me kundërshtim me frymën kushtetuese dhe me rekomandimet e Komisionit të Venedikut.

¹ Rregullorja e Punës së Kuvendit, neni 58.


3. ANALIZA E PUNËS SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Sikurse në seanca plenare, mungesa e kuorumit i ka karakterizuar edhe mbledhjet e komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror të vitit 2019. Mungesat dhe vonesat e deputetëve në mbledhjet e komisioneve kanë qenë shumë të theksuara në këtë sesion dhe shpesh kanë pamundësuar kuorumin dhe mbarëvajtjen e punimeve. Në tërësi, deputetët kanë shënuar 775 mungesa vetëm në angazhimin e tyre në komisione parlamentare. Ndërkaq si pasojë e mungesës së kuorumit gjatë kësaj periudhe kanë dështuar plot 23 mbledhje të komisioneve parlamentare.

Komisionet parlamentare kanë realizuar 227 mbledhje të rregullta dhe 11 dëgjime publike. Nëse e krahasojmë këtë performancë me periudhën e njëjtë të vitit që shkoi i bie të ketë rënie të theksuar në numra. Në sesionin pranveror të 2018-ës ishin realizuar gjithsej 260 mbledhje të komisioneve dhe 18 dëgjime publike. Për më tepër në atë periudhë Kuvendi kishte 4 komisione më pak. Nëse nga shifrat e sivjetme të mbledhjeve të komisioneve, i heqim katër komisionet ad-hoc dhe hetimore dhe i krahasojmë statistikën me vitin 2018, del të jenë mbajtur 25% më pak mbledhje këtë vit.



Komisionet parlamentare kanë realizuar **227 mbledhje të rregullta** dhe **11 dëgjime publike**. Nëse e krahasojmë këtë performancë me periudhën e njëjtë të vitit që shkoi i bie të ketë rënie të theksuar në numra. Në sesionin pranveror të 2018-ës ishin realizuar gjithsej **260 mbledhje të komisioneve** dhe **18 dëgjime publike**.



Ndonëse Rregullorja e Punës së Kuvendit obligon komisionet parlamentare të mbajnë së paku dy mbledhje brenda muajit², kjo dispozitë është respektuar vetëm nga katër komisione.³ Komisionet me më së shumti mbledhje të realizuara ishin: Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rinë, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi (24), Komisioni Hetimor Parlamentar në Lidhje me Gjendjen në PTK dhe Vala (24), Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal (20). Ndërkaq komisionet me më së paku mbledhje të realizuara gjatë vitit ishin Komisioni Ad-Hoc për Përpilimin e Kodit për Rregullimin dhe Menaxhimin e Fushës së Pensioneve dhe Beneficioneve nga Sigurimi Social (2), Komisioni Ad-Hoc për Përmirësimin dhe Forcimin e Procesit Zgjedhor (3), Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media (4).

Nga 11 dëgjime publike të mbajtura, 10 prej tyre për trajtimin e projektligjeve. Vetëm shtatë komisione parlamentare kanë

realizuar dëgjime publike qoftë për projektligje ose çështje të tjera. Ndërkaq, njëmbëdhjetë komisione parlamentare nuk kanë realizuar asnjë dëgjim publik.

Një prej aktiviteteve kryesore të Komisioneve është shqyrtimi dhe amendamenti i projektligjeve. Bazuar në planet e punës së komisioneve parlamentare për sesionin pranveror në cilësinë e komisioneve funksionale janë planifikuar të shqyrtohen 65 projektligje përdërisa kanë arritur të shqyrtohen vetëm 14 sosh.

Sa i përket Komisioneve të përhershme, Komisioni për Buxhet dhe Financa, të planifikuara kishte 10 ndërkaq ka shqyrtuar dy projektligje në cilësinë e komisionit funksional, njëra prej të cilave nuk ishte pjesë e planifikimit.⁴ Po ashtu ka shqyrtuar 9 projektligje në cilësinë e komisionit të përhershëm. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim nuk kishte shqyrtuar dhe as planifikuar të shqyr-

2 Rregullorja e Punës së Kuvendit, neni 64 (5).

3 Komisioni për Buxhet, Arsim, Zhvillim Ekonomik si dhe ai për Shëndetësi.

4 Ligji për Lojërat e Fatit.

tojë projektligje në cilësinë e komisionit funksional, përderisa ka shqyrtuar 12 sosh në cilësinë e komisionit të përhershëm. Komisioni për Legjislacion në cilësinë e komisionit funksional kishte planifikuar shqyrtimin e 13 projektligjeve teksa ka arritur të realizoi shqyrtimin e vetëm katër prej tyre. Sa i përket shqyrtimeve në cilësinë e komisionit të përhershëm kishte realizuar 12 sosh. Komisioni për Integritet Evropian nuk ka planifikuar të shqyrtojë ndonjë projektligj në cilësinë e komisionit funksional. Megjithatë jashtë planifikimit e ka shqyrtuar Projektligjin për fondet IPA. Gjithashtu ka shqyrtuar 16 projektligje në cilësinë e komisionit të përhershëm.

Ndërsa sa i përket Komisioneve funksionale, Komisioni për Punë të Jashtme kishte planifikuar dhe shqyrtuar tri projektligje. Komisioni për Arsim kishte planifikuar në planin e vetë të punës shqyrtimin e 8 projektligjeve por nuk ka arritur të shqyrtoj asnjë. Edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik kishte planifikuar shqyrtimin e 8 projektligjeve por nuk e ka shqyrtuar asnjë. Komisioni Bujqësi kishte planifikuar shqyrtimin e 8 projektligjeve kurse ka shqyrtuar dy prej tyre. Kurse Komisioni për Shëndetësi ka planifikuar shqyrtimin e tri projektligjeve teksa ka shqyrtuar vetëm një. Komisioni për Administratë Publike ka paraparë shqyrtimin e 7 projektligjeve por nuk ka shqyrtuar asnjë. Komisioni për Punë të Brendshme në planifikimet e veta ka paraparë shqyrtimin e 4 projektligjeve por ka shqyrtuar vetëm një. Komisioni për të Drejtat Njeriut ka paraparë shqyrtimin e një projektligji të cilën nuk e ka shqyrtuar gjatë periudhës raportuese. Ndërsa, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe ai për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë nuk kanë planifikuar që të shqyrtojnë asnjë projektligj për këtë periudhë kohore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë iniciuar pesë nisma legjislative nga komisionet parlamentare tri prej të cilave i ka iniciuar Komisioni për Legjislacion, një Komisioni për Punë të Brendshme dhe një Komisioni për Administratë.⁵ Të gjitha këto nisma kanë mbetur në procedurë të shqyrtimit.

Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse, komisionet parlamentare gjatë vitit 2019 kanë ftuar për raportim 38 herë ministrot e kabinetit qeveritar, numër ky identik me periudhën e njëjtë të vitit që shkoj.

Në aspektin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, ndonëse janë zhvilluar punime në këtë drejtim nga ana e komisioneve, Kuvendi nuk ka arritur të miratojë asnjë raport të monitorimit të zbatimit të ligjeve duke përmbyllur sesionin me 0 ligje të mbikëqyrura. Bazuar në planet e punës së 14 komisioneve parlamentare për 2019, ato përfshijnë plane për monitorimin e zbatimit të 26 ligjeve. Nëse shikojmë planifikimet vetëm për sesionin pranveror del të kenë pasur në plan monitorimin e zbatimit të 21 ligjeve. Megjithatë vetëm për 10 prej tyre komisionet kanë qenë në procedurë të realizimit të monitorimit, katër prej tyre kanë hartuar raporte por që nuk kanë arritur të kalojnë në seancë dhe si rrjedhojë nuk është finalizuar asnjë raport i monitorimit të zbatimit të ligjit.

5 Komisioni për Legjislacion kishte iniciuar hartimin e projektligjit për plotësim-ndryshimin e Kodit të drejtësisë për të miturit, Projektligjit për ndryshimin-plotësimin e Ligjit për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Komisioni për Punë të Brendshme kishte iniciuar hartimin e Projektligjit për komisionerin parlamentarë për FSK, kurse Komisioni për Administratë kishte iniciuar Projektligjin për Kuvendin e Kosovës.

|||||

	Mbledhje të mbajtura (Dëgjime Publike)	Projektligje të trajtuara (Kom. Funk/ përherëshme)	Dëgjimet publike për projektligje/ çështje tjera	Mungesa të deputetëve	Raportime të ministrave	Takime të anuluar
Buxhet dhe Financa	17/0	2/9	1/0	48	2	0
Të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	11/0	0/12	0	63	2	2
Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit	17/3	4/12	2/1	68	1	2
Integrime Evropiane	15/0	1/16	0	35	6	0
Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike	12/1	0	1/0	29	3	0
Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi	22/1	0	1/0	101	7	4
Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal	20/2	0	2/0	98	4	2
Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor	14/0	2	0	46	4	1
Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	14/2	1	2/0	55	3	2
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	4/1	0	1/0	14	0	0
Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje e Forcës së Sigurisë	9/0	1	0	29	1	1
Të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	18/1	0	1/0	63	2	0

|||||

|||||

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	11/0	0	0	45	2	2
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	6/0	0	0	/	0	0
Komisioni Ad-Hoc për Përmirësimin dhe Forcimin e Procesit Zgjedhor	3/0	0	0	8	0	1
Komisioni Ad-Hoc për Përpilimin e Kodit për Rregullimin dhe Menaxhimin e Fushës së Pensioneve dhe Beneficioneve nga Sigurimi Social	2/0	0	0	0	0	3
Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018	4/0	0	0	7	0	3
Komisioni Hetimor Parlamentar në Lidhje me Gjendjen në PTK dhe Vala	23/0	0	0	55	1	0
Komisioni Ad-hoc për hartimin e Projekt-Rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë	4/0	0	0	6	0	0
Total	227/11	11/49	10/1	770	38	23

FIG.5 Të dhënat e përgjithshme të performancës së komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror 2019

|||||



3.1 Komisionet hetimore

Sesioni pranveror ka gjetur Kuvendin me 6 komisione shtesë, 3 prej të cilave hetimore dhe 3 ad-hoc. Kjo punë shtesë që mori përsipër Kuvendi, nuk arriti të përmbushej. Shpërbërja e Kuvendit la në gjysëm misionet e këtyre komisioneve, shumica prej të cilave ishin në proces të zhvillimit të punimeve. Vetëm dy nga këto komisione arritën të miratojnë raportin final në seancë. Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me Ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018, ishte formuar në qershor të vitit 2018, ndërsa kishte nisur punën në korrik për të vazhduar më tutje deri deri fillim të muajit dhjetor kur edhe ka përfunduar mandati. Për shkak të volumit të punës, Komisioni nuk kishte arritur që të përmbyllë hetimet për periudhën 4- mujore sa kishte mandat. Për këtë arsye, Komisioni kishte shtruar kërkesa për vazhdim të mandatit edhe për një afat 30-ditor, e cila ishte miratuar nga Kuvendi. Ky komision kishte vazhduar operimin përgjatë muajve prill dhe maj të 2019-ës kur edhe i kishte mbajtur katër takime. Në këtë periudhë është hartuar edhe raporti përfundimtar i cili është miratuar nga Kuvendi.

Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me Gjendjen në PTK dhe Vala, i formuar nga Kuvendi më 7 mars 2019 është njëri prej komisioneve që ka pasur dinamikën më të madhe të punës (24 mbledhje të mbajtura). Ky komision ishte themeluar që të hetonte kontratat e dëmshme të PTK-së ndër vite dhe ndikimet politike nëpunësimet në PTK. Fillimisht ishte formuar me mandat 1 – mujor por më vonë me kërkesë të këtij Komisioni, mandati i tij u vazhdua edhe për pesë muaj të tjerë. Ky komision ka zhvilluar takimet në periudhën mars-gusht të 2019-ës dhe ka arritur të përmbyll punimet duke hartuar raportin përfundimtar. Megjithatë për shkak të shpërndarjes së Kuvendit, i njëjtë nuk ka arritur të kalojë në seancë. Ky komision ka intervistuar plot 22 persona.


Kurse Komisioni Hetimor parlamentar në lidhje me emërimet e Shërbyeseve të Lartë Civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nuk ka performuar fare, duke mos mbajtur asnjë mbledhje.

3.2 Komisionet ad – hoc

Kuvendi i Kosovës më 15 prill këtij viti ka themeluar Komisioni Ad-hoc për Përmirësimin dhe Forcimin e Procesit Zgjedhor. Formimi i këtij komisioni kishte ardhë si rezultat i nënshkrimit të një deklarate të përbashkët të kryetarëve të grupeve parlamentare më 11 prill të këtij viti. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte shprehja e gashmërisë së partive parlamentare për angazhim në përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, për adresimin e çështjet e rekomanduara nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian të zgjedhjeve paraprake parlamentare e lokale. Që prej kohës së themelimit, Komisionika mbajtur vetëm tri mbledhje. Si pasojë e shpërndarjes së Kuvendit, ky komision nuk arriti të përfundojë punën e vetë, duke mos hartuar as raportin final.

Një tjetër komision ad- hoc që u themelua nga Kuvendi po në të njëjtën datë ishte Komisioni Ad-hoc për Hartimin e Projekt-rezolutës për Gjenocidin, Krimet kundër njerëzimit dhe Krimet e luftës në Kosovë. Ky komision ka mbajtur gjithsej katër takime nga të cilat është hartuar rezoluta në fjalë dhe e njëjta është miratuar në seancë.

Një tjetër Komision ad –hoc i themeluar nga Kuvendi gjatë kësaj periudhe, ai për Përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe Beneficioneve nga sigurimi social u themelua nga më 2 shkurt të këtij viti më qëllim draftimin e një kodi pensional që do të rregullonte çështjet e skemave pensionale dhe beneficioneve sociale. Ky komision gjatë periudhës raportuese ka mbajtur vetëm dy takime. Për shkak të njëjta as ky komision nuk arriti të përmbush misionin e vet.



4. MBARËVAJTJA E SEANCAVE PARLAMENTARE

Përgjatë sesionit pranveror të vitit 2019, Kuvendi ka mbajtur gjithsej 31 seanca, prej të cilave 13 ishin plenare, 15 të jashtëzakonshme dhe tri solemne. Nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, këtë vit Kuvendi ka mbajtur katër seanca më shumë. Për krahasim, në vitin 2018, përgjatë sesionit pranveror Kuvendi kishte realizuar gjithsej 27 seanca, prej të cilave 16 ishin plenare, tetë të jashtëzakonshme dhe tri solemne.

Sikurse vitin e kaluar, edhe përgjatë vitit 2019 Kuvendi i Kosovës është ballafaquar me polarizim politik që gjenezën e kishte qysh nga konstituimi i legjislaturës së gjashtë. Kjo ka ndikuar direkt në mbarëvajtjen e punimeve plenare. Pas vendosjes së tarifës 100% për produktet nga Serbia dhe BeH nga ana e Qeverisë së Kosovës në dhjetor të vitit 2018, Lista Serbe përfundimisht ka bojkotuar punimet e Kuvendit. Për rrjedhojë, koalicioni qeverisës në vazhdimësi është ballafaquar me mungesë të shumicës parlamentare. Në këtë situatë, e gjithë agjenda e Kuvendit është varur nga pjesëmarrja e grupeve parlamentare opozitare në seanca, që ka mundur edhe votimin e ligjeve dhe pikave tjera të rendit të ditës. Ndonëse dy grupet më të mëdha opozitare, LDK dhe LVV nuk kanë marrë pjesë në votim në të gjitha pikat e rendit të ditës, GP i PSD-së ka qenë më bashkëpunues me koalicionin qeverisës, duke ua siguruar kuorumin e nevojshëm për votim, por edhe duke votuar në shumicën e pikave të rendit të ditës.

Mosorganizimi i mirëfilltë i punës së Kuvendit nga ana e Kryesisë së Kuvendit ka ndikuar në agjendën e çrregulltë seancave plenare. Si pasojë e mbledhjeve të rralla të Kryesisë së Kuvendit, dhe mos caktimit të seancave të reja, shumë pika të rendit të ditës janë grumbulluar dhe nuk kanë arritur të vendosen për trajtim, përkundër faktit që komisionet parlamentare kishin përfunduar punën e tyre në këtë drejtim. Si rrjedhojë, edhe në rastet kur janë mbajtur seanca plenare, numri i pikave të rendit të ditës ka qenë shumë i madh dhe shumica e pikave të parapara është dashur të shtyhen për seanca të tjera.

Për dallim nga sesioni pranveror i vitit të kaluar, këtë vit në Kuvend nuk është vërejtur përdorim i gjuhës joparlamentare. Megjithatë, diskutimet në seanca parlamentare shpeshherë kanë kaluar në debate personale e për çështje të cilat nuk ishin paraparë për diskutim.




FIG.6 Numri i seancave të mbajtura gjatë sesionit pranveror 2019

4.1 Seancat plenare


Gjatë sesionit pranveror, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 13 seanca plenare, prej të cilave gjashtë ishin të reja kurse shtatë vazhdime të seancave plenare. Kjo statistikë shpërfaqë më së miri mënyrën se si në fakt janë zhvilluar seancat plenare përgjatë këtij viti: shumë pika të rendit të ditës, pa kuorum dhe pa mundësi për t'u përfunduar në ditën kur janë filluar. Për krahasim me sesionin pranveror nga viti i kaluar, Kuvendi kësaj radhe kanë mbajtur 4 seanca më pak të këtij lloji.

Mungesa e kuorumit në shumicën e rasteve e ka pamundësuar zhvillimin normal të seancave plenare. Në shumicën e seancave të zhvilluar gjatë këtij sesioni, rendi i ditës ka qenë tejet i ngarkuar deri në 60 pika të rendit të ditës për një seancë. Edhe në rastet kur kishte kuorum, votimi i pikave të rendit të ditës zhvillohej pa debat të mirëfilltë, kurse përzgjedhja dhe votimi i anëtarëve të bordeve të agjensive të pavarura në seanca është karakterizuar me vonesa, të cilat kanë ndikuar edhe funksionalizimin e këtyre agjencive.

4.2 Seancat e jashtëzakonshme

Karakteristikë e sesionit pranveror të punës së Kuvendit për këtë vit ishte mbajtja e shpeshtë e seancave të jashtëzakonshme. Përgjatë kësaj periudhe, Kuvendi ka mbajtur gjithsej 15 seanca të jashtëzakonshme, ku në disa raste janë mbajtur deri në dy seanca të jashtëzakonshme brenda një dite. Ky është numri më i madh i seancave të jashtëzakonshme të mbajtura në një sesion të punës së Kuvendit nga të gjitha legjislaturat. Shumica e seancave të jashtëzakonshme janë thirrur nga opozita, gjegjësisht Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Më konkretisht, LVV ka thirrur shtatë seanca të jashtëzakonshme, LDK-ja pesë, dy seanca janë thirrur nga Kryesia e Kuvendit pas kërkesës së komisioneve parlamentare funksionale si dhe një tjetër nga Kryeministri Haradinaj.

Numri i madh i seancave të jashtëzakonshme gjatë këtij viti ka lënë mbrapa Kuvendin me trajtimin e pikave që kanë qenë të parapara për t'u shqyrtuar në seanca të rregullta plenare.





Përgjatë këtij sesioni Kuvendi ka pasur më tepër rol reaktiv, duke diskutuar mbi çështje të caktuara vetëm pasi ato ndodhnin andaj edhe rezultatet që kanë prodhuar këto debate ishin të pakta. Njësoj Kuvendi ka reaguar edhe me tema sociale, siç ishte rasti i përdhunimit të vajzës së mitur në Drenas, apo tentim-parandalimi i ikjes masive të të rinjëve nga Kosova e për të cilin rast nuk kishte arritur që miratonte rezolutën e hartuar.

Përgjatë këtij sesioni të punës, seanca të jashtëzakonshme janë thirrur edhe për të miratuar ligje, siç ishte rasti me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Karakteristikë tjetër e seancave të jashtëzakonshme ishte edhe numri i vogël i deputetëve që ishin pjesë e këtyre punimeve. Deputetët kanë qëndruar në sallë varësisht nga fakti se kush ka thirrur seancën e jashtëzakonshme: deputetët e koalicionit qeverisës kanë munguar në shumicën e seancave të thirrura nga opozita dhe e kundërta. Poashtu, në shumë raste, edhe vetë deputetët nënshkruen për seanca të jashtëzakonshme kanë munguar në diskutimet e realizuara përgjatë këtyre seancave.

4.3 Seancat solemne

Kuvendi ka mbajtur tri seanca solemne. Që të tri këto seanca janë mbajtur përgjatë periudhës shkurt - maj. Në seancën e parë solemne për këtë vit, deputetët ishin mbledhur për të shënuar 11-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së vendit, më pasaj në një seancë tjetër në mars për të shënuar 21 vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kurse seanca e tretë solemne për periudhën raportuese është mbajtur në maj për të shënuar 21-vjetorin e masakrës në Burgun e Dubravës.

4.4 Pjesëmarrja e deputetëve në seanca

Një numër i madh i mungesave të deputetëve janë shënuar në seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe. Në total, numri i përgjithshëm i mungesave të deputetëve për këtë sesion është

685 mungesa. Nëse kalkulohet mesatarja e mungesave për secilin deputet, i bie që secili nga 120 deputetët ka munguar mesatarisht 6 herë gjatë këtij sesioni, ndërsa mesatarisht në secilën seancë kanë munguar deri në 25 deputetë.



Një numër i madh i mungesave të deputetëve janë shënuar në seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe. Në total, numri i përgjithshëm i mungesave të deputetëve për këtë sesion është **685 mungesa**. Nëse kalkulohet mesatarja e mungesave për secilin deputet, i bie që secili nga **120 deputetët** ka munguar mesatarisht **6 herë** gjatë këtij sesioni, ndërsa mesatarisht në secilën seancë kanë munguar deri në **25 deputetë**.






FIG.7 Mungesat e deputetëve në seanca plenare: numri total dhe mesatarja sipas grupeve parlamentare

Lista Serbe është grupi parlamentar që ka më së shumti mungesa, me gjithsej 259 mungesa, që mesatarisht secili deputetë i këtij grupi parlamentar kanë munguar rreth 26 herë. Numri i madh i mungesave të deputetëve të grupit parlamentar të Listës Serbe është si rezultat i bojkotit parlamentar që ky grup parlamentar i ka bërë punës së Kuvendit që nga muaji mars i vitit 2018.

Grupi parlamentar i PDK-së është grupi i dytë parlamentar me më së shumti mungesa, gjithsej 94 mungesa (mesatarja 4 mungesa për deputetë). LDK ka regjistruar 81 mungesa (mesatarja 3 mungesa për deputetë), LVV ka 85 mungesa (mesatarja 4 mungesa për deputetë), pasuar nga PSD me 68 mungesa (mesatarja 6 mungesa për deputetë), AAK me 43 mungesa (mesatarja 3 mungesa për deputetë), NISMA me 25 mungesa (mesatarja 3 mungesa për deputetë), 6+ me 10 mungesa (mesatarja rreth 2 mungesa për

deputetë) dhe deputetët pa grup parlamentar me 20 mungesa (mesatarja 5 mungesa për deputetë). Sa u përket mungesave individuale të deputetëve, dhjetë deputetët me më së shumti mungesa të realizuara përgjatë sesionit pranveror janë: Slavko Simić, Verica Ceranić e Miljana Nikolić me nga 27 mungesa, ndjekur nga Igor Simić, Jasmina Zivković, Srdjan Mitrović e Jelena Bontić me nga 26 mungesa, Sasa Milosavljević me 24 mungesa, Adem Hodža me 23 dhe Gani Dreshaj me 20 sosh.

Në anën tjetër, janë gjithësej 15 deputetë që nuk kanë munguar asnjëherë në seanca parlamentare: Muharrem Nitaj dhe Shkumbin Demaliaj (AAK), Albert Kinolli (6+), Arbër Rexhaj, Sali Zyba, Rexhep Selimi dhe Sami Kurteshi (LVV), Bilall Sherifi dhe Emilija Redzeqi (NISMA), Imet Rrahmani, Kujtim Shala dhe Mirjeta Kalludra (LDK) Luljeta Veselaj-Gutaj (PDK) si dhe Driton Çausi e Shqipe Pantina (PSD).





5. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Kuvendi mund ta mbaj ekzekutivin përgjegjës përmes disa mekanizmave por që ky institucion nuk ka qenë shumë aktiv në ushtrimin e këtij funksioni gjatë periudhës raportuese. Për dallim nga viti i kaluar për periudhën e njëjtë kur Kuvendi kishte treguar performancë të mirë sa i takon mbikëqyrjes përmes mekanizmave të saj, këtë periudhë mbikëqyrja parlamentare ka qenë e dobët.

5.1 Pyetjet Parlamentare

Gjatë sesionit pranveror 2019, vetëm 30 deputetët të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar pyetje parlamentare. Gjithsej janë parashtruar 94 pyetje parlamentare për kabinetin qeveritar, ku prej tyre vetëm 38 kanë marrë përgjigje. Krahasuar me sesionin e kaluar pranveror, ku u parashtruan gjithsej 238 pyetje parlamentare, këtë sesion Kuvendi i Kosovës është shquar për numër shumë të vogël të pyetjeve parlamentare. Megjithatë 56 pyetje kanë mbetur pa përgjigje.

je për shkak të mosprezencës së ministrave. Për më tepër, vonesat në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara ka bërë që të humbet rëndësia e tyre dhe në disa raste deputetët kanë refuzuar të parashtrojnë pyetjet e tyre për shkak të mosprezencës së ministrave përkatës.

Pjesa dërrmuese e pyetjeve parlamentare të parashtruara vijnë nga deputetët e opozitës, prej të cilëve LVV-ja kryeson me numrin më të madh të pyetjeve me gjithsej 43 pyetjeve parlamentare prej të cilave përgjigje ka marrë në 25 prej tyre, e pasuar nga grupi parlamentar i LDK-së me 24 pyetje parlamentare ndërkaq përgjigje ka marrë në 2 prej tyre. Grupi parlamentar i PSD-së ka parashtruar 12 pyetje parlamentare prej të cilave 3 kanë marrë përgjigje. Grupi parlamentar i PDK-së me 13 pyetje parlamentare ku prej tyre 8 kanë marrë përgjigje. Ndërkaq, nga deputetët e pavarur janë parashtruar 2 pyetje parlamentare të cilët nuk kanë marrë përgjigje. Deputetët nga grupi parlamentar i AAK dhe NISMA nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare gjatë periudhës raportuese.

56
Pyetje të cilat nuk kanë marrë përgjigje



38
Pyetje që kanë marrë përgjigje







FIG. 9 Totali i pyetjeve parlamentare dhe numri i pyetjeve me përgjigje sipas grupeve parlamentare

Ministritë e udhëhequra nga subjekti politik NISMA kanë qenë më të targetuar nga deputetët në parashtrim të pyetjeve parlamentare. Ministrave nga radhët e NISMA's u janë drejtuar 32% e pyetjeve parlamentare të parashtruara gjatë sesionit pranveror të këtij viti, ndërkaq përgjigje kanë marrë rreth 83% e këtyre pyetjeve. Një pjesë tjetër e pyetjeve gjegjësisht 27% e pyetjeve parlamentare u janë drejtuar ministrave të PDK'së të cilët kanë dhënë përgjigje në 40% të tyre. Rreth 24% e pyetjeve parlamentare u janë drejtuar ministrave nga radhët e AAK-së ku përfshihen edhe pyetjet drejtuar ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, të cilët kanë dhënë përgjigje në vetëm 4% të tyre. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve, 16% e tyre kanë qenë të parashtruar ndaj ministrave të AKR-së, ku vetëm për 13% të tyre kanë pasur përgjigje ministrat përkatës ndërkaq vetëm 1% e pyetjeve u janë drejtuar LS-së të cilët nuk u janë përgjigjur atyre.

Ministri ndaj të cilit janë parashtruar më së shumti pyetje parlamentare është ai i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi (NISMA) me 17 pyetje nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara, pasuar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj (AAK) ndaj të cilit janë parashtruar 16 pyetje dhe Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica (NISMA) me gjithsej 12 pyetje.





MINISTRI/JA	SUBJEKTI POLITIK	PYETJE	PËRGJIGJE	NUK ËSHTË PËRGJIGJUR
Ableard Tahiri	PDK	3	0	3
Kujtim Gashi	PDK	7	6	1
Shyqiri Bytyqi	NISMA	17	14	3
Bedri Hamza	PDK	5	4	1
Valdrin Lluka	AKR	4	0	4
Dhurata Hoxha	PDK	0	0	0
Rrustem Berisha	AKK	2	1	1
Skender Reçica	NISMA	12	10	2
Dijana Živić	LS	1	0	1
Behgjet Pacolli	AKR	1	0	1
Pal Lekaj	AAK	5	0	5
Uran Ismaili	PDK	10	0	10
Ramush Haradinaj	AAK	16	0	16
Bajram Hasani	NISMA	0	0	0
Ivan Teodosijević	LS	0	0	0
Rasim Demiri	VAKAT	0	0	0
Besim Beqaj	PDK	0	0	0
Dardan Gashi	Pa Parti	0	0	0
Mahir Yagcilar	KDTP	0	0	0
Dalibor Jevtic	LS	0	0	0
Fatmir Limaj	NISMA	0	0	0
Endrit Shala	NISMA	1	1	0
Fatmir Matoshi	AKR	2	2	0
Fatmir Limaj	NISMA	1	0	1
Endrit Shala	NISMA	5	5	0
Fatmir Matoshi	AKR	1	1	0
Ekrem Mustafa	AKR	8	0	8

FIG.10 Pyetjet parlamentare ndaj Kabinetit Qeveritar

Shikuar në bazë të sektorëve ku janë parashtruar pyetjet shohim se pyetjet e parashtruara kanë qenë të koncentruara më shumë në tri sektorë, atij për Arsim ku janë parashtruar 17 pyetje parlamentare, Punë të brendshme 14 pyetje parlamentare dhe në Sociale 12 pyetje. Sektorët e tjerë ku janë parashtruar pyetjet janë: Shëndetësi (10), Kulturë (7), Financa, Drejtësi dhe Mjedis nga (5), Punë të Jashtme (4), Qeverisje

Lokale dhe Ekonomi nga (3), Energji dhe Komunikacion nga (2), Bujqësi dhe Blegtori, Tregti, Siguri, Planifikim Hapësinor dhe Administratë me nga 1 pyetje.






FIG. 11 Pyetjet parlamentare të ndara sipas sektorëve

Për nga aspekti gjinor, numri i deputetëve burra dhe deputeteve që kanë parashtruar pyetje është po thuajse i barabartë, 16 deputetë burra dhe 14 deputete gra. Nëse shohim numrin e pyetjeve të parashtruara nga deputetët burra dhe deputetet gra është poashtu i përafërt, ku deputetët burra kanë parashtruar 55% të pyetjeve parlamentare, ndërkaq deputetet gra i kanë parashtruar 45% të tyre.

Nga 120 deputetë të Kuvendit të Kosovës, vetëm 30 prej tyre kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të bërë pyetje parlamentare për ekzekutivin, ku prej tyre 12 deputetët nga LVV, 6 nga LDK, 6 nga PDK, 5 nga PSD, dhe 1 nga deputetët e pavarur. Deputetët më aktiv në parashtrimin e pyetjeve parlamentare për këtë periudhë ishin: Avdullah Hoti nga LDK (13), i pasuar nga Albulena Haxhiu, Arbërie Nagavci, Ismail Kurteshi, Shemsi Sylja nga LVV nga (5), Aida Dërguti PSD (5),



ndërkaq deputetët me më së paku pyetje (1) janë deputetët: (LDK), Naser Rugova (LDK), Dardan Sejdiu (PSD), Driton Qaushin Hoti (PDK), Sala Berisha-Shala (PDK), Haxhi Avdyli (LDK) dhe Haxhi Avdyli (PSD).

GRUPI PARLAMENTAR	DEPUTETI/JA	NUMRI I PYETJEVE
PDK	Andin Hoti	1
	Bekim Haxhiu	2
	Ganimete Musliu	2
	Luljeta Veselaj-Gutaj	2
	Sala Berisha-Shala	1
	Mexhide Mjaku - Topalli	4
LDK	Armend Zemaj	4
	Avdullah Hoti	13
	Doruntinë Maloku-Kastrati	2
	Haxhi Avdyli	1
	Naser Rugova	1
	Korab Sejdiu	3
LVV	Albulena Haxhiu	5
	Arbërie Nagavci	5
	Arbër Rexhaj	4
	Drita Millaku	3
	Fatmire Kollçaku	4
	Glauk Konjufca	2
	Ismail Kurteshi	5
	Syla Zyba	3
	Sami Kurteshi	2
	Saranda Bogujevci	2
	Shemsi Syla	5
	Xhelal Sevçla	4
	Aida Dërguti	5
PSD	Besa Baftiu	2
	Dardan Sejdiu	1
	Driton Qaushi	1
	Shqipe Pantina	3
PA GRUP	Mimoza Kusari - Lila	2

FIG.12 Deputetët dhe numri i pyetjeve parlamentare të parashtruara nga ta

5.2 Interpelancat

Interpelancat janë një nga mjetet kryesore me anë të së cilave deputetët ushtrojnë funksionin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit. Për dallim nga sesioni pranveror i vitit të kaluar, kur deputetët kishin thirrur 12 interpelanca, përgjatë këtij viti nga janari deri në gusht janë mbajtur vetëm dy interpelanca. Të dy interpelancat e këtij sesioni janë thirrur nga grupi parlamentar i PSD-së, dhe i janë drejtuar Kryeministrit Ramush Haradinaj dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Që të dy interpelancat janë mbajtur në të njëjtën ditë.

Interpelanca për Kryeministrin Haradinaj ishte thirrur për shkak të mos-caktimit dhe rritjes së pagës minimale në vend. Me këtë rast, me datën 30 maj u miratua edhe Rezoluta e propozuar nga PSD-ja, përmes së cilës i bëhej thirrje Këshillit Ekonomiko-Social që t'i propozoj Qeverisë pagën minimale në vend, në harmoni me Ligjin e Punës.

Kurse, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ishte thirrur po në të njëjtën ditë në interpelancë lidhur me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. A. Debati lidhur me çështjen për të cilën ishte thirrur interpelanca kishte përfunduar po atë ditë, kurse projekt-rezoluta u caktua për votim në vazhdimin e seancës plenare të mbajtur me 19 qershor. Megjithatë, përkundër pranisë së 66 deputetëve në sallë, për këtë projekt-rezolutë kishin votuar vetëm 38 deputetë, dhe në mungesë të kuorumit kjo rezolutë nuk u votua.

5.3 Debatet parlamentare

Në sesionin pranveror të punës së Kuvendit janë realizuar gjithësej 12 debate parlamentare, për dallim nga sesioni pranveror i vitit të kaluar ku ishin realizuar 15 sosh. Nëntë nga 12 debatet parlamentare të mbajtura përgjatë këtij sesioni të punës janë realizuar përmes seancave të jashtëzakonshme, kurse tri debate të tjera janë realizuar si pjesë e seancave plenare. Nga 12 debate parlamentare të real-

izuara, dhjetë nga to u inicuan nga deputetë nga opozita, kurse vetëm dy nga deputetët nga koalicioni qeverisës. Më konkretisht, Lëvizja Vetëvendosje ka thirrur gjashtë debate parlamentare, LDK ka thirrur katër, kurse nga një është inicuar nga AAK dhe NISMA.



Në sesionin pranveror të punës së Kuvendit janë realizuar gjithësej **12 debate parlamentare**, për dallim nga sesioni pranveror i vitit të kaluar ku ishin realizuar **15 sosh**.





FIG.13 Numri i debateve parlamentare të ndara sipas grupeve parlamentare





Edhe këtë vit, debatet parlamentare janë karakterizuar me interesim të ulët të deputetëve për pjesëmarrje në to. Përgjatë zhvillimit të debatave, zakonisht në sallën e Kuvendit kanë qëndruar një numër i vogël i deputetëve. Mungesa e kuorumit si dhe mos-harmonizimi i qëndrimeve lidhur me çështjet e debatuar kanë ndikuar që debatet parlamentare të përfundojnë pa konkretizim, pra duke mos arritur të votohen rekomandime as rezoluta për shumicën e temave për të cilat është debatuar. Nga të gjitha debatet parlamentare të realizuara, vetëm në një rast është arritur të miratohet Rezolutë, lidhur me heqjen e monopolit për homologimin e veturave.

5.4 Rezolutat

Ndonëse pa fuqi juridike e obligative, Rezolutat janë ndër aktet kryesore të cilat nxirren nga Kuvendi, e të cilat shërbejnë për të dhënë qëndrimin e organit më të lartë legjislativ për tema e çështje të caktuara. Përkundër problemeve të theksuara me mungesën e kuorumit, përgjatë sesionit pranveror të punës së Kuvendit janë miratuar gjithsej pesë rezoluta.

Rezoluta e parë e miratuar për vitin 2019 ishte ajo për pezullimin e aktivitetit të të gjitha lojërave të fatit, me datën 22 mars.⁶Përmes kësaj Rezolutive, Kuvendi i bënte thirrje Qeverisë që në afat prej 30 ditësh të procedoj në Kuvend Projektligjin me anë të së cilit do të ndalohej aktiviteti i lojërave të fatit për një periudhë 10-vjeçare.

Në vazhdimin e seancës plenare të mbajtur me 16 maj u miratuan dy rezolutat e radhës nga ana e deputetëve të Kuvendit. Së pari, me kërkesën e Komisionit Ad-Hoc për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, pas harmonizimit të tekstit

nga të gjitha grupet parlamentare, u miratua rezoluta për gjenocidin e kryer serb në Kosovë.⁷ Përmes kësaj rezolutive, Kuvendi bëri në pah krimet serbe të kryera në Kosovë, dhe kërkonte nga institucionet politike dhe shkencore në vend që të ndriçonin në tërësi gjenocidin në Kosovë dhe të ndërmyrreshin hapa konkret në përfshirjen e veprave të ndërlidhura me gjenocidin në Kodin Penal të Kosovës. Kjo rezolutë i parapriu edhe formimit të Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë.

Rezoluta tjetër e miratuar në seancën e 16 majit ishte ajo për krijimin e "Këndit të Kurajos",⁸ e propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi. Përmes kësaj rezolutive, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca zotoheshin që të ndanin hapësira ku do të pasqyroheshin punimet e viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë. Poashtu, përmes kësaj rezolutive, Kuvendi bënte thirrje që përmes shitjes së këtyre punimeve të ndihmoheshin direkt ekonomitë familjare të viktimave të dhunës seksuale në vend.

Një Rezolutë tjetër e miratuar në Kuvendin e Kosovës ishte edhe Rezoluta e propozuar nga PSD, përmes së cilës i bëhej thirrje Këshillit Ekonomiko-Social që t'i propozoj Qeverisë pagën minimale në vend, në harmoni me Ligjin e Punës.⁹ Kjo rezolutë u miratua pas interpelancës së thirrur nga PSD kundrejt kryeministrit Haradinaj lidhur me pagën minimale. Poashtu, përmes kësaj rezolutive, ndër të tjera, Kuvendi obligonte Qeverinë e vendit si dhe Këshillin Ekonomiko-Social që të respektoj këtë rezolutë më së largu brenda një afati prej 30 ditësh. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në praktikë.


6 Kuvendi i Kosovës: Rezoluta Nr.06-R-016 për pezullimin e aktivitetit të lojërave të fatit. E qasshme në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta%20nr.06-R-016%20pezullimi%20i%20aktiviteteve%20te%20lojerave%20te%20fatit.pdf> (qasur më 07.08.2019)

7 Kuvendi i Kosovës: Rezoluta 06-R-017 përgjenocidin e kryer serb në Kosovë. E qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2019_06_03_Rezolut%C3%AB%20nr.%20017%20p%C3%ABr%20gjenocidin%20e%20kryer%20serb%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.%20dt.16.05.2019.pdf (qasur më 07.08.2019)

8 Kuvendi i Kosovës: Rezoluta 06-R-018 për krijimin e Këndit të Kurajos. E qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2019_05_22_REZO-LUT%C3%8B_06_R018_P%C3%ABr%20krijimin%20e%20K%C3%ABndit%20t%C3%AB%20Kurajos_Alb+Srb.pdf (qasur më 07.08.2019)

9 Kuvendi i Kosovës: Rezoluta 06-R-019 në lidhje me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Kosovë. E qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2019_06_06_Rezolut%C3%AB%2006-R-019%20p%C3%ABr%20çaktimin%20e%20Pag%C3%ABs%20minimale.pdf (qasur më 08.08.2019)






5

Rezoluta të miratuara

4

Draft rezoluta që nuk janë miratuar në mungesë kuorumi





5.5 Mbikëqyrja e institucioneve të pavarura

Një prej pikave më të dobëta në performancën e përgjithshme të mbikëqyrjes nga Kuvendi i Kosovës gjatë sesionit pranveror të këtij viti ka qenë në përmbushjen e rolit mbikëqyrës ndaj agjencive të pavarura. Deri në përfundim të sesionit pranveror, Komisionet nuk kanë arritur që të shqyrtojnë të gjitha raportet e institucioneve të pavarura. Ndërkaq edhe ato që janë shqyrtuar nga komisionet nuk kanë marrë miratim final në seancë ashtu siç parashihet me Rregulloren. Mirëpo, me Rregulloren të Punës nuk është e specifikuar afati kohor kur Kuvendi i Kosovës gjegjësisht Komisionet parlamentare duhet të shqyrtojnë dhe miratojnë raportet e institucioneve të pavarura.

Për periudhën raportuese, Komisionet Parlamentare kanë shqyrtuar raportet vjetore për vitin 2018 të 21 institucioneve të pavarura nga 34 sa i mbikëqyrin, dhe 9 raporte të auditimit të institucioneve mirëpo asnjë nga këto raporte ende nuk janë miratuar në seancë.

Në anën tjetër, as emërimi i anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura nuk është bërë në kohë. Kuvendi për mungesë kuorumi ka dështuar të emëroj anëtarët e bordeve për disa institucione të pavarura brenda afatit kohor. Që nga muaji tetor i vitit të kaluar, Kuvendi nuk ka arritur që të emëroj 19 anëtarë për tri institucione të pavarura, ndërkaq pesë anëtarë të bordeve të pesë institucioneve të tjera të pavarura nuk kanë arritur të marrin vota të mjaftueshme për çka është kërkuar të përsëritet konkursi.

Për këtë periudhë kohore, Kuvendi ka përzgjedhur 7 anëtarë të bordeve për tri institucione të pavarura (Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, Komisionit për Ndihmë Shtetërore, Agjencinë Kosovare të Privatizimit), si dhe ka emëruar drejtorin e Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Naser Shalën dhe Bajram Zejnullahu për kryesues të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

5.6 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve


Kuvendi i Kosovës gjatë sesionit pranveror 2019, nuk ka arritur të mbikëqyr zbatimin e asnjë ligji, ndonëse sipas Rregullores së Punës e ka për detyrë një gjë të tillë. Bazuar në planet e punës së 14 komisioneve parlamentare për 2019, ato përfshijnë plane për monitorimin e zbatimit të 26 ligjeve. Nëse shikojmë planifikimet vetëm për sesionin pranveror del të kenë pasur në plan monitorimin e zbatimit të 21 ligjeve, për 10 prej të cilave komisionet kanë qenë në procedurë të realizimit të monitorimit. Katër prej tyre kanë hartuar raporte por që nuk kanë arritur të kalojnë në seancë dhe si rrjedhojë nuk është finalizuar asnjë monitorim i zbatimit të ligjit.





21

LIGJE TË PLANIFIKUARA



10

LIGJE NË
PROCEDURË




0

LIGJE TË
MBIKËQYRURA

FIG.15 Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve gjatë sesionit pranveror 2019

Komisionet të cilat kanë qenë duke punuar në drejtim të monitorimit të zbatimit të ligjit gjatë sesionit pranveror janë: Komisioni për Punë të Brendshme, ka monitoruar Lig-

jin për Inspektoratin policor për çka ka arritur të hartoj edhe raportin. Komisioni për Shëndetësi, ka monitoruar Ligji për produkte dhe pajisje medicinale për çka ka hartuar raportin.



Komisioni për Zhvillim ekonomik ka realizuar monitorimin e Ligjit për Energji elektrike si dhe Ligjin për Shërbime nga Komisioni për Zhvillim ekonomik për çka ka hartuar raportet. Po ashtu Komisioni për Legjislacion ka përfunduar monitorimin e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në fazë fillestare të punës ishin Komisioni për Mbikëqyrjen e financave publike lidhur me Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike, Komisioni për të drejtat e njeriut lidhur me Ligjin për barazi gjinore.

Gjithashtu Komisioni për Arsim kishte nisur punën për monitorim të tri ligjeve: Ligjin për Trashëgimin kulturore, Ligji për Arsimin Parauniversitar (që e kishte planifikuar për sesion vjeshtor) si dhe Ligjin për Inspektoratin e Arsimit.

Nga kjo shihet se komisionet parlamentare në planet e tyre të punës vazhdojnë të reflektojnë jo proporcionalisht rolet dhe përgjegjësitë që kanë. Shqyrtimi i projektligjeve është aktiviteti kryesor (në planet e punës kanë paraparë shqyrtimin e 116 projektligjeve), ndërsa mbikëqyrja është aktiviteti më marginal.

5.7 Raportimi i ministrave në komisionet parlamentare

Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse, Komisionet Parlamentare gjatë sesionit pranveror 2019 kanë ftuar për raportim 38 herë anëtarët e kabinetit qeveritar. Në kuadër të raportimeve të ministrave, përveç diskutimit mbi çështjet që bien në fushëprimtarinë e ministrave përkatës janë përfshirë edhe prezantimet e projektligjeve nga ana e ministrave në Komisione që janë sponsorizuar nga ministritë e linjës.

Ministrat që janë ftuar më së shumti për raportime në komisione parlamentare gjatë këtij sesioni janë ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Shyqiri Bytyqi me gjashtë raportime, ministria e Integritimit Evropian znj. Dhurata Hoxha pesë raportime, ministri i Punëve të Brendshme

z. Ekrem Mustafa katër herë, ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Fatmir Matoshi tri herë. Gjithashtu edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka tri herë.

Ndërkaq sa i përket Komisioneve që kanë ftuar më së shumti ministra në raportim prinë Komisioni Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi i cili kishte ftuar për raportim shtatë herë ministrat të tri ministrave. Prej tyre, pesë herë ishte ftuar në raportim ministri i Arsimit Shyqiri Bytyqi, nga një herë ishin ftuar ministrat si në vijim: z. Kujtim Gashi dhe z. Besim Beqaj. Komisioni për Integritim Evropian kishte ftuar gjashtë ministra në raportim: katër herë raporto i ministrja e Integritimit Dhurata Hoxha kurse nga një herë: ministri i Drejtësisë Abelard Tahiri dhe ministri i Brendshëm Ekrem Mustafa. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, kishte ftuar katër herë ministrat e linjës në raportim, tri raportime bëri ministri i Mjedisit Fatmir Matoshi ndërkaq një raport ministria e Bujqësisë znj. Dijana Zivić. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, po ashtu kishte ftuar katër herë ministrat për raportim: dy herë kishte raportuar ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka dhe dy herë ai i Infrastrukturës z. Pal Lekaj. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kishte tri raportime: ministri i Shëndetësisë z. Uran Ismaili, raporto i dy herë dhe një herë ai i Punës, z. Skender Reçica. Ndërkaq gjashtë komisione të tjera (duke përfshirë edhe ato hetimore dhe ad-hoc) nuk kishin asnjë raportim të ministrave.

6. SHPENZIMET E KUVENDIT

Kuvendi i Kosovës, deri në shpërndarjen e kësaj legjislature, ka miratuar dhe publikuar vetëm raportin financiar për tre-mujorin e parë të këtij viti. Pavarësisht mospublikimit në kohë të raporteve tremujore financiare, Kuvendi gjatë 2019, ka adresuar rekomandimin e KDI-së për publikimin e shpenzimeve në mënyrë më të detajuar. Raportet e shpenzimeve përmbajnë datat që tregojnë se sa kanë qëndruar deputetët në një udhëtim të caktuar, megjithatë nuk specifikojnë arsyet e vizitave dhe të dhënat për shpenzimet e biletave.

Për vitin 2019, buxheti i ndarë për Kuvendin e Kosovës ishte 11,219,281.00€. Për kategorinë Paga dhe Mëditje kanë qenë të parapara të shpenzohen 7,136,281.00€ ose shprehur në përqindje 63.61% e buxhetit të përgjithshëm. Për kategoritë e tjera, si ajo për Mallra dhe Shërbime janë planifikuar 2,212,000.00€ (19.72%), për Shpenzimet komunale janë planifikuar 241,000.00€ (2.15%), për Shpenzimet kapitale është planifikuar një buxhet prej 1,490,000.00€ (13.28%), dhe në kategorinë për Subvencione dhe transfere janë planifikuar gjithsej 140,000.00€ (1.25%) të buxhetit.

Në bazë të raportit tre mujor për vitin 2019, Kuvendi i Kosovës ka shpenzuar 1,913,029.68€ apo 17.05% të buxhetit total për vitin 2019. Për këtë periudhë kohore, buxhetit të shtetit i kanë kushtuar 1,579,777.94 € vetëm pagat dhe mëditjet e deputetëve, apo shprehur në përqindje 22% e buxhetit të përgjithshëm të kësaj kategorie është shpenzuar nga Kuvendi për këtë periudhë kohore. Në kategorinë për Shpenzimet Komunale janë shpenzuar 71,159.40 € apo 29% e buxhetit total të paraparë për këtë kategori. Sa i përket 'Subvencioneve dhe Transfereve' buxheti i shpenzuar për tre muaj është 35,166.00 € ose 25% e buxhetit vjetor të ndarë për këtë kategori. Në 'Mallra dhe Shërbime' për periudhën raportuese janë shpenzuar 226,926.34 € apo në përqindje 10% e buxhetit të destinuar për këtë kategori. Ndërkaq, për 'Shpenzimet Kapitale' nuk është raportuar për shpenzim të buxhetit të paraparë për këtë kategori.



Për vetëm tre muajt e parë të vitit 2019, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë udhëtuar 62 herë jashtë vendit të cilat i kanë kushtuar buxhetit të shtetit gjithsej 51,726.95 €, që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (60,380.28 € shpenzime në 74 udhëtime të realizuara) vërehet një rritje e lehtë e mesatares së shpenzimeve për udhëtim. Në bazë të raportit financiar për periudhën janar - mars, del se nga 120 deputetë të Kuvendit, 43 prej tyre kanë realizuar udhëtime jashtë vendit.

Numri më i madh i këtyre vizitave janë realizuar në vendet e kontinentit të Evropës (55), me përjashtim të 5 vizitave në kontinentin e Amerikës dhe 2 vizita në kontinentin e Azisë. Kurse, vendet më të vizituara nga deputetët janë Franca me 17 vizita, pasuar nga Shqipëria me 14 dhe Brukseli me 7 vizita.



FIG.16 Numri i udhëtimeve zyrtare të deputetëve sipas kontinenteve



Grupi parlamentar me më së shumti udhëtime jashtë vendit është grupi parlamentar i PDK-së me gjithsej 18 udhëtime jashtë vendit të realizuara vetëm gjatë periudhës janar–mars 2019. Nga 23 deputetë sa ka gjithsej grupi parlamentar i PDK-së, 11 prej tyre kanë udhëtuar të paktën njëherë gjatë kësaj periudhe. Destinacionet më të vizituara të deputetëve të PDK-së kanë qenë Franca me 5 udhëtime dhe Shqipëria me 3 udhëtime të realizuara, në këtë shtet.

Grupi i dytë parlamentar me më së shumti udhëtime, në bazë të raporteve të disponueshme, është grupi parlamentar i LDK-së, deputetët e së cilit grup kanë realizuar gjithsej 15 udhëtime jashtë vendit. Nga numri i përgjithshëm i deputetëve që ka ky grup parlamentar (25), 10 prej tyre kanë realizuar udhëtime jashtë vendit. Franca është vendi më i vizituar edhe për grupin parlamentar të LDK-së, me gjithsej 5 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara.

Në bazë të raporteve të shpenzimeve, del që grupi i tretë parlamentar me më së shumti udhëtime është grupi parlamentar 6+, deputetët e së cilit grup kanë realizuar gjithsej 7 udhëtime jashtë vendit. Nga 6 deputetë që janë pjesë e këtij grupi parlamentar, 4 prej tyre kanë realizuar të paktën një udhëtim jashtë vendit. Vendi ku janë realizuar më së shumti udhëtime të grupit parlamentar të 6+ është Turqia, me gjithsej 3 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara nga ky grup. Me numër të njëjtë të udhëtimeve sikurse grupi i lartpërmendur është edhe grupi parlamentar i LVV-së, me gjithsej 7 udhëtime të realizuara jashtë vendit. Janë 7 deputetë të këtij grupi parlamentar, nga 19 deputetë sa janë gjithsej, që kanë realizuar udhëtime jashtë vendit. Shqipëria dhe Franca janë vendet me më së shumti udhëtime nga ky grup parlamentar, me gjithsej 4 udhëtime nga numri i përgjithshëm i udhëtimeve të realizuara.

Dy grupet e tjera parlamentare, AAK-ja dhe NISMA kanë realizuar nga 5 udhëtime jashtë vendit për këtë periudhë kohore. Nga AAK-ja, tre nga 13 deputetët sa ka në përbërje ky grup parlamentar, kanë udhëtuar të paktën njëherë gjatë periudhës janar–mars 2019. Ndërsa nga grupi parlamen-

tar i NISMA-së udhëtime kanë realizuar 4 nga 8 deputetë sa ka gjithsej ky grup. Të dyja këto grupe parlamentare numrin më të madh të vizitave e ka realizuar në Shqipëri, me nga 2 udhëtime gjithsej.

Grupi tjetër me më së shumti udhëtime në tre mujorin e vitit 2019, është grupi parlamentar i PSD-së, të cilët kanë realizuar në total 4 udhëtime jashtë vendit. Tre deputetë nga 12 sa janë gjithsej pjesë të këtij grupi parlamentar, kanë realizuar të paktën nga një udhëtim. Franca është shteti më i vizituar nga grupi parlamentar i PSD-së me gjithsej 3 udhëtime.

Ndërkaq, një nga tre deputetët që janë pa grup parlamentar, Slobdan Petrović ka realizuar një (1) udhëtim jashtë vendit, gjegjësisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA).







FIG.17 Udhëtimet e deputetëve sipas grupeve parlamentare





8. REKOMANDIMET

- 1** Duke marrë parasysh shumë praktika jo të mira parlamentare që janë aplikuar nga Kuvendi për shkak të zbrastirave ligjore brenda Rregullores aktuale, KDI vlerëson që është më se e domosdoshme që Kuvendi i ri të miratojë në afat sa më të shpejtë kohor Rregulloren e Re, e cila do t'i adresonte këto defekte. Duke qenë se miratimi i Rregullores së Re kërkon 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, nevojitet anagzhim më i madh nga grupet parlamentare për arritjen e një konsensus më i gjerë mes tyre duke i tejkaluar kështu dallimet sa i përket përmbajtjes së kësaj Rregullorje në funksion të përmirësimit të rregullave të procedurave parlamentare.
- 2** Një prej problematikave të Kuvendit gjatë kësaj legjislatore ka qenë mosorganizimi i mirëfillët i punës, gjë e cila ka ndikuar në mbarëvatjen e secilit organ brenda Kuvendit. Duke qenë se është detyrë e Kryesisë së Kuvendit që të garantoj mbarëvatjen e punimeve të Kuvendit, kjo nuk ka reflektuar në punën e këtij organi gjatë periudhës raportuese. Për të garantuar mbarëvatjen e punimeve në Kuvend, Kryesia duhet të mbajë mbledhjet e saj në afate kohore të rregullta, të bëj planifikimin mujor të punimeve dhe të garantoj zbatimin e atij plani nga të gjitha trupat e Kuvendit.
- 3** Mbikëqyrje ndaj Agjencive të Pavarura aktualisht është ndër pikat më të dobëta të punës së Kuvendit. Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës është mekanizmi i vetëm me të cilën Kuvendi mban nën mbikëqyrje këto institucione. Krahas reformës se paraparë për racionalizimin e një numri të madh të këtyre agjencive/institucioneve të pavarura, duhet të vendosen masat ndëshkimore në ligjet bazike që rregullojnë funksionimin e këtyre institucioneve dhe që kjo procedurë të njihet me Rregulloren e re të punës. Raportet të cilat nuk miratohen nga Kuvendi për shkak të performancës së dobët të këtyre organeve dhe mos zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi, duhet të shoqërohen me penalizime për udhëheqësit e tyre.
- 4** Komisionet parlamentare, në planet e tyre të punës të shpërndajnë në mënyrë proporcionale funksionet dhe përgjegjësitë që lidhen me ligjbërjen dhe mbikëqyrjen dhe t'i rishikojnë praktikatat e përcaktimit dhe përzgjedhjes së ligjeve për mbikëqyrje. Përsëritja e kritikave të Komisionit Evropian për Kosovën në raport me mbikëqyrjen e dobët në zbatimin e ligjeve të bëhet prioritet strategjik i Kuvendit.





KDI përmes Raportit të vlerësimit për punën e Kuvendit për vitin 2018, kishte ofruar shtatë rekomandime për Kuvendin, prej të cilave vetëm një është plotësuar pjesërisht, ai për raportet e shpenzimeve të deputetëve. Prandaj të njëjtat rekomandohet që të adresohen nga Kuvendi. Shih rekomandimet e vitit **2018**.

- 1** Si institucioni më i lartë përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e shpenzimit të buxhetit të shtetit, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë shembull për të gjitha institucionet tjera sa i përket transparencës financiare. Raportet e shpenzimeve duhet të publikohen me kohë dhe të jenë të detajuara, të përmbajnë informata mbi qëllimet e vizitave të deputetëve jashtë vendit. Kuvendi i Kosovës do të duhej të publikonte vendimet e Kryesisë së Kuvendit për secilin udhëtim të aprovuar të deputetëve.
- 2** Edhe pse një numër i madh i ligjeve janë miratuar këtë vit, shqyrtimi i tyre nuk i është nënshtruar debatit të mirëfilltë publik, duke komprometuar kështu parimin e gjithpërfshirjes dhe të konsultimit me palët e interesit. Kjo mangësi e theksuar vazhdimisht edhe në Raportet për Kosovën të Komisionit Evropian, duhet të adresohet me seriozitet në mënyrë që qytetarëve dhe grupeve të interesit t'u mundësohet dhënia e kontributit dhe pronësia në procesin ligjvënës e rrjedhimisht të garantohet një implementim më i mirë i tyre në praktikë.
- 3** Në të kaluarën, dështimi i Qeverisë për të sjellë projektligje në Kuvend i është faturuar Kuvendit si dështim për mospërbushjen e agjendës legjislative. Për të shmangur këtë skenar, Kuvendi do të duhet të bashkërendonte me Qeverinë hartimin e agjendës legjislative, në mënyrë që ajo të mos jetë shumë ambicioze dhe përtej kapaciteteve të të dyja institucioneve.
- 4** Krahas funksionit të tij ligjvënës, Kuvendi do të duhej që proporcionalisht t'i kushtojë rëndësi mbikëqyrjes efektive të zbatimit të ligjeve, sidomos kur ngecjet e vendit në përgjithësi i atribuohen moszbatimit të ligjeve. Korniza ligjore në Kosovë vetëm sa është drejt plotësimit me ligjet kryesore dhe fokusi për të ardhmen duhet të jetë në aktivitetet e shtuara mbikëqyrëse. Kuvendi duhet të ketë në fokus monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe mbikëqyrjen e qeverisë në mënyrë sistematike.
- 5** Kuvendi duhet ta rikthejë praktikën e mbajtjes së seancave në ditën e enjte eventualisht në të premten, ashtu siç parashihet me Rregulloren e Punës, në mënyrë që t'i jepet hapësirë komisioneve parlamentare që mbledhjet e tyre t'i mbajnë ditëve të tjera. Në këtë mënyrë do të zvogëlohej mundësia e dështimit qoftë të seancave ose të mbledhjeve të komisioneve dhe të grumbullimit të çështjeve që duhet të shqyrtohen.
- 6** Mbajtja e seancave plenare deri në orët e vona të natës ulë transparencën e Kuvendit karshi publikut dhe ua pamundëson qytetarëve që të përcjellin shqyrtimin dhe votimin e projektligjeve në shqyrtim. Andaj, Kuvendi i Kosovës duhet ta ndërpres këtë praktikë jo të mirë parlamentare, dhe të organizoj punimet në atë mënyrë që deputetët të jenë efikas në punën e tyre dhe qytetarët të kenë mundësinë të përcjellin punimet e Kuvendit.
- 7** Mungesat e deputetëve do të duhej të rregulloheshin përmes Rregullores së re të Punës së Kuvendit. Rregullorja aktuale nuk parasheh ndonjë masë ndëshkuese për deputetët të cilët nuk marrin pjesë në punimet e Kuvendit, dhe u ofron mundësinë e mospjesëmarrjes në punë për gjashtë muaj me radhë. Kjo zbrazëti ligjore është shfrytëzuar nga deputetët dhe ka ndikuar direkt në mundësimin e bojkotimit të punës së Kuvendit.





SHTOJCAT

SHTOJCA 1 - Pjesëmarrja e deputetëve në Komisione Parlamentare

Komisioni për Buxhet dhe Financa		
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Lumir Abdixhiku	15	2
Safete Hadërgjonaj	16	1
Ali Lajçi	13	4
Naser Osmani	14	3
Mërgim Lushtaku	16	1
Fikrim Damka	14	3
Jelena Bontić	3	14
Dardan Molliqaj	9	8
Blerim Kuçi	12	5
Enver Hoti	15	2
Arbërie Nagavci	12	5

Komisioni për të drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim		
Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Xhelal Sveçla	10	1
Kujtim Shala	5	6
Fadil Beka	9	2
Zoran Mojsilović	1	10
Jasmina Živković	0	11
Saša Milosavljević	1	10
Rasim Selmanaj	10	1
Albert Kinolli	11	0
Müfera Şinik	10	1
Danush Ademi	11	0
Duda Balje	6	5
Igor Simić	1	10
Veton Berisha	10	1
Haxhi Shala	6	5
Slobodan Petrović	10	1





Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e AKK-së

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Albulena Haxhiu	18	2
Hajdar Beqa	16	4
Bahrim Šabani	16	4
Sami Kurteshi	16	4
Arben Gashi	11	9
Korab Sejdiu	15	5
Shkumbin Demaliaj	16	4
Bilall Sherifi	15	5
Xhevahire Izmaku	14	6
Frashër Krasniqi	15	5
Igor Simić	0	20

Komisioni për Integritete Evropiane

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Blerta Deliu - Kodra	15	0
Zenun Pajaziti	13	2
Armend Zemaj	14	1
Milaim Zeka	13	2
Fikrim Damka	12	3
Fatmire Mulhaxha - Kollçaku	13	2
Adem Hodža	0	15
Donika Kadaj – Bujupi	13	2
Visar Ymeri	13	2
Ismajl Kurteshi	14	1
Ismet Beqiri	10	5






Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Vjosa Osmani - Sadriu	11	2
Danush Ademi	10	3
Time Kadrijaj	12	1
Glauk Konjufca	8	5
Fitore Pacolli	6	7
Dukagjin Gorani	10	3
Doruntinë Maloku	9	4
Elmi Reçica	12	1
Evgjeni Thaçi	12	1
Zafir Berisha	12	1
Srdjan Mitrović	12	1

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Ismajl Kurteshi	23	0
Teuta Haxhiu	22	1
Müfera Şinik	14	9
Arbërie Nagavci	12	11
Albulena Balaj-Halimaj	14	9
Driton Çausi	21	2
Valentina Bujaku-Rexhepi	12	11
Verica Ćeranić	1	22
Fidan Rekalju	6	17
Abdyl Salihu	9	14
Luljeta Veselaj-Gutaj	14	5






Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Sala Berisha-Shala	22	0
Dardan Sejdiu	13	9
Duda Balje	12	10
Glauk Konjufca	10	12
Hykmete Bajrami	14	8
Memli Krasniqi	10	12
Muharrem Nitaj	18	4
Veton Berisha	18	4
Liburn Aliu	7	15
Adem Hodža	3	19
Lutfi Zharku	17	5

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Muharrem Nitaj	14	0
Besa Gaxherri	12	2
Srdjan Mitrović	1	13
Andin Hoti	12	2
Danush Ademi	12	2
Liburn Aliu	4	10
Ganimete Musliu	10	4
Lutfi Zharku	12	2
Salih Salihu	12	2
Salih Zyba	13	1
Etem Arifi	6	8





Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Besa Baftiu	16	0
Enver Hoti	10	6
Haxhi Avdyli	10	6
Flora Brovina	10	6
Bekim Haxhiu	12	4
Fikrim Damka	9	7
Miljana Nikolić	0	16
Fatmire Mulhaxha - Kollçaku	14	2
Naser Rugova	14	2
Time Kadriaj	13	3
Drita Millaku	13	3

Komisioni për Administratë Publike, Media dhe Qeverisje Lokale

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Nait Hasani	5	0
Milaim Zeka	5	0
Albert Kinolli	5	0
Xhevahire Izmaku	3	2
Imet Rahmani	5	0
Arban Abrashi	4	1
Shqipe Pantina*	1	2
Valon Ramadani	4	1
Rasim Selmanaj	5	0
Adem Mikollovci	1	4
Jasmina Živković	1	4

*Deputetja Shqipe Pantina nga mbledhja e katërt ka dhënë dorëheqje nga ky komision.






Komisioni për Punë të Brendshme

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Haxhi Shala	8	1
Rexhep Selimi	8	1
Zoran Mojsilović	1	8
Xhelal Sveçla	9	0
Aida Dërguti	9	0
Ismet Beqiri	8	1
Ramiz Kelmendi	0	9
Fatmir Xhelili	7	2
Fadil Beka	9	0
Labinot Tahiri*	4	2
Bahrim Šabani	6	3
Muharrem Nitaj*	1	2

*Deputeti Muharrem Nitaj nga mbledhja e katërt është zëvendësuar me deputetin Labinot Tahiri.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Duda Balje	18	1
Lirije Kajtazi	17	2
Saša Milosavljević	3	16
Teuta Haxhiu	19	0
Luljeta Veselaj - Gutaj	16	3
Mexhide Mjaku - Topalli	15	4
Mirjeta Kalludra	15	4
Saranda Bogujevci	11	8
Veton Berisha	15	4
Fisnik Ismaili	6	13
Shemsi Syla	11	8





Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Driton Selmanaj	11	0
Mërgim Lushtaku	10	1
Albert Kinolli	11	0
Valon Ramadani	5	6
Avdullah Hoti	9	2
Andin Hoti	4	7
Emilja Redžepi	10	1
Ali Lajçi	9	2
Faton Topalli	0	11
Etem Arifi	7	4
Verica Ćeranić	0	11

Komisioni Ad-hoc për hartimin e Projekt-Rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Armend Zemaj	4	0
Saranda Bogujevci	2	2
Muharrem Nitaj	4	0
Aida Dërguti	4	0
Bilall Sherifi	4	0
Danush Ademi	0	4
Mërgim Lushtaku	4	0





Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Visar Ymeri	24	0
Milaim Zeka	19	5
Armend Zemaj	24	0
Haxhi Avdyli	16	8
Bekim Haxhiu	20	4
Blerta Deliu - Kodra	17	7
Liburn Aliu	15	9
Albulena Haxhiu	21	3
Shkumbin Demaliaj	15	9
Fikrim Damka	9	15

Komisioni Ad-hoc për përmirësimin dhe forcimin e Procesit Zgjedhor

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Avdullah Hoti	3	0
Memli Krasniqi	2	1
Albert Kinolli	3	0
Ahmet Isufi	3	0
Blerta Deliu-Kodra	2	1
Lirije Kajtazi	2	1
Bilall Sherifi	2	1
Dardan Sejdiu	1	2
Saša Milosavljević	3	0
Albulena Haxhiu	2	1
Glauk Konjufca	2	1





Komisioni Hetimor Paramentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasëve turq me datë 29 mars 2018

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Xhelal Sveçla	4	0
Driton Selmanaj	4	0
Anton Quni	4	0
Sami Kurteshi	4	0
Hajdar Beqa	2	2
Ganimete Musliu	2	2
Frashër Krasniqi	3	1
Muharrem Nitaj	4	0
Haxhi Shala	3	1
Bahrim Šabani	3	1

Komisioni Ad-hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social

Deputeti/ja	Pjesëmarrja	Mungesa
Dardan Sejdiu	2	0
Blerim Kuçi	2	0
Enver Hoti	2	0
Fikrim Damka	2	0
Flora Brovina	2	0
Safete Hadërkhonaj	2	0



SHTOJCA 2 – Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare

NUMRI I SEANCAVE SIPAS MUAJVE		1	3	6								
Emri dhe Mbiemri	Grupi parlamentar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Pjesëmarrje	Mungesa	
ABDYL SALIHU	PDK	1	2	2	4	4	4	0	1	18	10	
ADEM HODŽA	LS	0	1	1	1	0	0	0	0	3	25	
ADEM MIKULLOVI	LVV	1	2	0	0	4	4	1	0	12	16	
MUHARREM NITAJ	AAK	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0	
AHMET ISUFI	AAK	1	3	8	3	5	5	1	1	27	1	
AIDA DËRGUTI	PSD	1	3	6	3	3	1	1	1	19	9	
ALBIN KURTI	LVV	1	1	0	3	5	3	1	1	15	13	
ALBULENA BALAJ- HALIMAJ	NISMA	1	3	7	2	5	5	1	1	25	3	
ALBULENA HAXHIU	LVV	1	3	6	4	4	4	1	1	24	4	
ALI LAJÇI	LVV	1	3	9	1	5	5	1	1	26	2	
ALBERT KINOLLI	6+	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0	
ANDIN HOTI	PDK	1	3	8	2	5	4	1	1	25	3	
ANTON QUNI	LDK	1	2	9	4	4	4	1	1	26	2	
ARBAN ABRASHI	LDK	1	3	7	2	4	4	1	1	23	5	
ARBEN GASHI	LDK	1	2	9	4	3	4	0	1	24	4	
ARBËR REXHAJ	LVV	1	3	9	4	5	4	1	1	28	0	
ARBERIJE NAGAVCI	LVV	1	3	8	4	5	3	0	1	25	3	
ARMEND ZEMAJ	LDK	1	3	9	4	4	4	1	1	27	1	
AVDULLAH HOTI	LDK	0	2	9	4	5	5	1	1	27	1	
BEKË BERISHA	AAK	1	3	6	4	5	5	1	1	26	2	
BEKIM HAXHIU	PDK	1	3	6	4	5	5	0	1	25	3	
BESA BAFTIU	PSD	1	3	7	4	4	5	1	1	26	2	
BESA GAXHERRI	LDK	1	3	8	4	4	5	1	1	27	1	
BILALL SHERIFI	NISMA	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0	
BLERIM KUÇI	AAK	1	3	8	3	4	5	1	1	26	2	
BLERTA DELIU - KODRA	PDK	1	3	8	4	5	4	1	1	27	1	
BAHRIM ŠABANI	6+	1	3	8	4	4	5	1	1	27	1	
DANUSH ADEMI	6+	1	3	9	3	5	4	1	1	27	1	
DARDAN MOLLIQAJ	PSD	1	3	7	4	5	1	0	1	22	6	
DARDAN SEJDIU	PSD	1	2	8	2	4	2	0	1	20	8	
DAUT HARADINAJ	AAK	1	2	8	3	5	5	1	1	26	2	
DONIKA KADAJ - BUJUPI	AAK	1	3	7	4	5	4	0	1	25	3	
DORUNTINË MALOKU - KASTRATI	LDK	1	3	9	3	5	4	1	1	27	1	
DRITA MILLAKU	LVV	1	3	6	4	5	3	1	1	24	4	
DRITON ÇAUSHI	PSD	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0	
DRITON SELMANAJ	LDK	0	2	9	2	5	4	1	1	24	4	
DUDA BALJE	6+	1	3	8	3	4	5	1	1	26	2	
DUKAGJIN GORANI	PSD	1	3	5	3	5	4	1	1	23	5	

|||||

ELMI REÇICA	PDK	1	3	8	4	4	5	1	1	27	1
EMILIJA REDŽEPI	AAK	1	2	9	4	5	5	1	1	28	0
ENVER HOTI	NISMA	1	2	6	4	4	5	1	1	24	4
ETEM ARIFI	NISMA	1	3	8	3	5	5	0	1	26	2
EVGJENI THAÇI - DRAGUSHA	PDK	1	3	4	4	5	5	1	1	24	4
FADIL BEKA	PDK	1	2	8	4	5	4	1	1	26	2
FATMIR XHELILI	PDK	1	3	8	4	4	5	1	1	27	1
FATMIRE KOLLÇAKU	LVV	1	3	7	3	3	5	1	1	24	4
FATON TOPALLI	PSD	1	3	6	1	2	4	0	1	18	10
FIDAN REKALIU	LDK	1	2	8	2	4	5	1	1	24	4
FIKRIM DAMKA	6+	0	3	7	4	5	4	1	1	25	3
FISNIK ISMAILI	PSD	1	2	3	1	2	2	0	0	11	17
FITORE PACOLLI - DALIPI	LVV	0	3	8	4	5	4	1	1	26	2
FLORA BROVINA	PDK	1	2	8	3	3	5	1	1	24	4
FRASHËR KRASNIQI	PSD	1	3	7	3	4	5	1	1	25	3
GANI DRESHAJ	AAK	1	1	1	3	0	0	1	1	8	20
GANIMETE MUSLIU	PDK	0	3	6	4	4	5	1	1	24	4
GLAUK KONJUFCA	LVV	1	3	3	4	5	5	1	1	23	5
HAJDAR BEQA	PDK	1	3	8	4	5	4	1	1	27	1
HAXHI AVDYLI	LDK	1	3	9	3	4	4	1	1	26	2
HAXHI SHALA	NISMA	1	3	7	3	4	2	0	0	20	8
HYKMETE BAJRAMI	LDK	1	3	9	4	4	2	0	1	24	4
IGOR SIMIĆ	LS	0	0	1	1	0	0	0	0	2	26
ILIR DEDA	PA GRUP	1	3	8	3	5	2	0	1	23	5
IMET RRAHMANI	LDK	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
ISLAM PACOLLI	PA GRUP	1	2	9	3	4	4	1	1	25	3
ISMAJL KURTESHI	LVV	1	3	8	3	5	5	1	1	27	1
ISMET BEQIRI	LDK	1	3	3	3	3	1	0	1	15	13
JASMINA ŽIVKOVIĆ	LS	0	0	1	1	0	0	0	0	2	26
JELENA BONTIĆ	LS	0	0	1	1	0	0	0	0	2	26
KADRI VESELI	PDK	1	3	8	2	5	4	1	1	25	3
KORAB SEJDIU	LDK	1	3	4	4	4	2	1	1	20	8
KUJTIM SHALA	LDK	1	3	9	4	4	5	1	1	28	0
LABINOT TAHIRI	AAK	0	2	7	3	5	4	1	1	23	5
LIBURN ALIU	LVV	1	3	6	2	1	4	1	1	19	9
LIRIJE KAJTAZI	LDK	1	3	7	4	4	5	1	1	26	2
LULJETA VESELAJ - GUTAJ	PDK	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
LUMIR ABDIXHIKU	LDK	1	3	9	4	4	4	0	1	26	2
LUTFI ZHARKU	LDK	1	3	7	4	5	5	1	1	27	1
MEMLI KRASNIQI	PDK	1	2	5	4	4	5	1	1	23	5
MERGIM LUSHTAKU	PDK	1	3	6	4	5	4	1	1	25	3
MEXHIDE MJAKU - TOPALLI	PDK	1	3	7	4	4	3	1	1	24	4
MILAIM ZEKA	NISMA	1	2	8	4	5	5	1	1	27	1

|||||



MILJANA NIKOLIĆ	LS	0	0	1	0	0	0	0	0	1	27
MIMOZA KUSARI - LILA	PA GRUP	1	3	5	4	2	4	0	1	20	8
MIRJETA KALLUDRA	LDK	1	3	9	4	5	4	1	1	28	0
MUFERA SRBICA - ŠINIK	6+	1	3	8	4	5	3	1	0	25	3
SHEMSI SYLA	LVV	1	3	9	3	5	3	1	1	26	2
NAIT HASANI	PDK	1	2	8	3	5	4	1	1	25	3
NASER OSMANI	LDK	1	3	8	3	5	4	1	1	26	2
NASER RUGOVA	LDK	1	3	7	4	5	5	1	1	27	1
RAFET RAMA	PDK			0	4	5	1	0	1	11	17
SALI ZYBA	LVV	1	3	9	4	4	5	1	1	28	0
RAMIZ KERMENDI	LDK	0	2	6	3	1	5	0	1	18	10
RASIM SELMANAJ	AAK	1	3	7	4	5	5	1	1	27	1
REXHEP SELIMI	LVV	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
SAFETE HADËRGJONAJ	PDK	1	3	7	2	5	5	1	1	25	3
SALA BERISHA- SHALA	PDK	1	3	5	4	5	5	1	1	25	3
SALIH SALIHU	PSD	1	2	7	4	2	4	1	1	22	6
SAMI KURTESHI	LVV	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
SARANDA BOGULJEVCI	LVV	1	1	3	4	3	1	1	1	15	13
SAŠA MILOSAVLJEVIĆ	LS	0	0	1	1	0	2	0	0	4	24
SHKUMBIN DEMALIAJ	AAK	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
SHOJPE PANTINA	PSD	1	3	8	4	5	5	1	1	28	0
SLAVKO SIMIĆ	LS	0	0	1	0	0	0	0	0	1	27
SLOBODAN PETROVIĆ	PA GRUP	1	2	8	2	4	5	1	1	24	4
SRDJAN MITROVIĆ	LS	0	1	1	0	0	0	0	0	2	26
TEUTA HAXHIU	AAK	1	3	8	4	4	5	1	1	27	1
TEUTA RUGOVA	LDK	1	2	7	3	4	5	1	1	24	4
TIME KADRIJAJ	AAK	1	3	3	4	4	5	1	1	22	6
VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI	LDK	1	3	7	4	4	5	1	1	26	2
VALON RAMADANI	LVV	1	3	7	2	5	4	1	1	24	4
VERICA ĆERANIĆ	LS	0	0	1	0	0	0	0	0	1	27
VETON BERISHA	NISMA	1	3	8	4	5	3	1	1	26	2
VISAR YMERI	PSD	1	3	7	4	4	5	1	1	26	2
VJOSA OSMANI - SADRIU	LDK	1	3	3	2	5	5	1	1	21	7
XHAVIT HALITI	PDK	1	2	9	3	1	1	1	1	19	9
XHELAL SVEĀLA	LVV	1	2	8	3	4	5	1	1	25	3
XHEVAHIRE IZMAKU	PDK	1	3	4	2	5	4	1	1	21	7
ZAFIR BERISHA	NISMA	1	2	6	3	5	4	1	1	23	5
ZENUN PAJAZITI	PDK	0	3	7	3	5	5	1	1	25	3
ZORAN MOJSILOVIĆ	LS	0	0	1	2	0	0	0	0	3	25

Numri total i mungesave 685

Mesatarja e mungesave për deputetë 5.71

